

Nga ZEKERIJA IDRIZI - rreth poezisë "Çaste mëngjesi" të poetit KUJTIM HAJDARI

NGA AGIMI METAFIZIK TE RREZATIMI I SHPRESËS DHE ZJARR-DRITËS PROMETEIKE.

Zekerija Idrizi: Një qasje estetiko-filozofike mbi poezinë "Çaste mëngjesi" - "Morning Moments" të poetit me renome ndërkombëtare, z. **Kujtim Hajdari**

Në poezinë "Çaste mëngjesi", poeti Kujtim Hajdari, një zë me renome ndërkombëtare në letërsinë shqipe, ndërton një himn për jetën përmes një qasjeje lirike ku mëngjesi shndërrohet në metaforë të shpresës, ringjalljes shpirtërore dhe dashurisë që rilind nga "pluhuri" i natës. Poezia është një përjetim estetik dhe filozofik i këtij autori, ku agimi nuk është thjesht një ndërrim kohe, por një çast kozmik ku shpirti njerëzor takohet me dritën hyjnore, me amëshimin poetik të ekzistencës.

Qysh në vargun hapës, "Agimi hap, në vesën e freskët, gjoksin djaloshar", poeti Hajdari e "konverton" rrezatimin e natyrës në "trupin" e gjallë dhe të dashur të universit. Mëngjesi transformohet metaforikisht në një qenie të re, rinore/djaloshar, që i ofron prehje dashurisë së "lodhur nga nata e ftohtë" – një metaforë e butë kjo për rraskapitjen shpirtërore që vetëm drita e brendshme mund ta kurojë. Qielli, "kanavacë e larë në ar", është një sfond i transformimit estetik, ku poeti ndërthur penelin vizual me ndjeshmërinë shpirtërore.

Një nga kulmet e poezisë është figura e diellit si "poet që digjet", i cili përmes "ujëvarës së vargjeve" jo vetëm që e ngroh thjesht tokën, por e ringjall atë. Në këtë pikëvështrim, Hajdari arrin të ndërthurë poetikën me filozofinë, ku drita nuk është vetëm energji fizike, por edhe akt krijues, si fjala poetike që "ta ribëjë e ta ringjallë tokën". Këtu, del qartësisht edhe një qasje prometheike e poetit tonë erudit, K. Hajdarit, ku dielli, si figurë alegorike që "digjet për të tjerët", bart në vetvete sakrificën e Prometheut që solli zjarrin për njerëzimin. Edhe Hajdari, përmes figurës së "poetit-diell", flet për atë që djeg e shkrin vetveten për t'u dhënë të tjerëve shpresë, ngrohtësi, jetë, duke e ngritur poezinë nga përshkrimi estetik në një akt etik dhe mitik.

Kjo, do thosha, është një ndërthurje delikate nëpërmjet të poetikës së rilindjes dhe nevojës jetësore për kuptimësi, në një botë të sotmen të mbingarkuar me "halle dhe andralla", me shumë terr, megjullnajë e tymnajë.

Në strofën e tretë, përmes një gjuhe simbolike, sensuale e metafizike, poeti ynë flet për ndezjen e imazheve në detin e dëshirave, ku drita dhe ëndrra shkrihen në unison, bëhen një: një bashkim o sintezë kjo e shenjtë simbiotike e shpirtërores (sakrales) me tokësoren (sekularen). Hijet "të turpëruara si fantazma" janë mbeturinat e natës, të së kaluarës, që shuhën nën ndikimin e fuqishëm diellor / dritëndezës të dashurisë dhe rilindjes, katarsisit.

Kulmi emocional dhe shpirtëror i kësaj poezie qëndron në dy strofat e fundit. Mëngjesi është "zjarri i parë i shpresës", një Feniks që ngjallet nga hiri i natës. Poeti e mishëron dritën si çelës të lulëzimit: një figurë kjo simbolike e jetës që kërkon të lulëzojë pas netëve të ftohta e të zbrazëta, bosh. Filladi i mëngjesit, ndërsa, që "hap sytë si një puthje e ëmbël mbi ball", është një ndër metaforat më të ndjera të prekjes së ngrohtë, njerëzore e shpirtërore, që përmban në vetvete dashurinë e pakushtëzuar të një fillimi të ri.

Kujtim Hajdari e mbyll poezinë me një urë ndërmjet përjetimit personal (autorial) dhe domethënies universale. "Kupat e verës së vjetër", që janë rrezet e mëngjesit, lidhen me një

ndjeshmëri dioniziane, ku jeta duhet të shijohet, të kuptohet e të përjetohet në thellësi (Shprehja “dioniziane” vjen nga emri i perëndisë greke Dionisi ose Bakhusi në mitologjinë romake, i cili ishte hyu i verës, ekstazës, festës, pasionit dhe çlirimit shpirtëror. Në letërsi, filozofi dhe estetikë, termi “dionizian” është bërë pjesë e fjalorit kritik, veçanërisht pas përdorimit të tij nga Friedrich Nietzsche në veprën “Lindja e tragjedisë” (Die Geburt der Tragödie, 1872).

Përmes kësaj poezie Hajdari nuk kërkon vetëm të zgjohet, por të nisë faqe të reja, të cilat presin të mbushen me përjetime, kuptim dhe dritë. Rrjedhimisht, përmes këtyre vargjeve ai na fton në një përjetim të thellë të mëngjesit jo si kronotop (hapësirë-kohë poetike/çast simbolik, ose çast kulmor në hapësirën shpirtërore), por si një ngjarje shpirtërore, si çast i zbulesës poetike, ku universi dhe njeriu, shpresa dhe kujtesa, e djeshmja dhe e nesërmja, ndërthuren simbiotikisht në një akt të heshtur përjetësimi.

Definitivisht, “Çaste mëngjesi” është një poezi që nuk përshkruan mëngjesin thjesht si fenomen natyror, por e shndërron atë në një përvojë të përbashkët estetiko-metafizike, ku çdo lexues gjen agimin e vet të brendshëm, rilindjen / katarzën, madje edhe zjarrin e vet prometëik për të ndriçuar botën.

E përgëzoj përzemërsisht mikun tim, poetin erudit Kujtim Hajdari, për këtë perlë poetike që të freskon artistikisht, estetikisht, madje edhe filozofikisht!

Nga Zekerija Idrizi

ÇASTE MËNGJESI

Agimi hap, në vesën e freskët, gjoksin djaloshar,
Ku gjen qetësinë dashuria e lodhur nga nata e ftohtë,
Qielli, një kanavacë e pikturuar, e larë në ar,
Shtyn errësirën e gjunjëzuar e na fton me shikimin e ngrohtë.

Dielli, një poet që digjet, me ëndrrën e dëshirën e zjarrtë,
Vargjet e tij derdh nga lart si ujëvara përrallash,
Ta ribëjë e ta ringjall tokën me dorën e artë,
Një simfoni për zemrat mbytur hallesh e andrallash.

Imazhet tona mbi detin e flakës së dëshirave,
Shkëlqejnë e ndizen ku ëndrra dhe drita takohen butë,
Ndërsa hije, të turpëruar si fantazma, tërhiqen në turp,
E humbin në ngrohtësinë e përkëdheljes së ëmbël.

Mëngjes i bukur, zjarri im i parë i shpresës,

Phoenix që ngrihesh nga pluhuri i natës së përgjumur,
Drita jote—çelësi i luleve që shpërthejnë, luleve të jetës,
Flladi yt më hap sytë si një puthje e ëmbël mbi ball.

Në freskinë tënde gjej qetësinë si në asnjë vend tjetër,
Në agimet tua brilante - nënshkrime të jetës vetë,
Më lër të shijoj rrezet e tua si kupat e verës së vjetër,
Të nis faqet e reja, që presin të shkruhen e të marrin jetë.
Kujtim Hajdari